

Halil (Hasan) Balaj

(15.04.1942, shqiptar nga Dobërdelani/
Dobrodeljane, komuna e Suharekës/Suva Reka,
bujk, shtatë fëmijë)

Në datën 27.08.1998, pjesëtarë të Repartit të 37 të NJPP-së kanë depërtuar në **Dobërdelan/Dobrodeljane**. Shumica e banorëve e ka braktisur fshatin gjatë bombardimeve, që i paraprinë hyrjes së këmbësisorisë. Halili me nënën e moshuar Fatimen dhe motrën Hatixhen ndenjën në shtëpi. Ishin strehuar në bodrum. Për një çast, Halili doli jashtë që të mbushte ujë nga bunari. Pas pak, Hatixhja dhe Fatimja dëgjuan një krismë pushke. Hatixhja doli në oborr dhe e gjeti Halilin të plagosur rëndë. E kishin qëlluar nga shpina. E ka bartur në bodrum. Më vonë, policia serbe i ka gjetur që të tre në bodrum. Ia lidhën plagën Halilit. Ditën tjetër [28.08.1998], herët në mëngjes, Halili ka dhënë shpirt. Atë ditë, një familjar, i cili u kthye në fshat, së bashku me disa ushtarë të UÇK-së e kanë varrosur Halilin në varrezat e fshatit fqinj të Pagarushës/Pagaruša [Malishevë/Mališevo]. Pas përfundimit të luftës, më 29.08.2002, familja i ka varrosur mbetjet mortore të Halilit në varrezat e Dobërdelanit/Dobrodeljane.

Burimet: deklarata L.B, FDH-11191; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838.

Hamzi (Ibrahim) Bytyqi

(18.08.1965, shqiptar nga Peqani/Peçane,
komuna e Suharekës/Suva Reka, inxhinier i
makinerisë, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Për një kohë të gjatë, Hamziu nuk ka mundur të punësohej në profesionin e vet dhe, për këtë arsye, në vitin 1997 ka shkuar në Slloveni për të kërkuar punë. U kthye në **Peqan/Peçane** në muajin janar të vitit 1998. Menjëherë u inkuadrua në shtabin lokal të UÇK-së. Ka pësuar nga një granatë më 29.08.1998, përderisa i mbante pozicionet në dalje nga Peqani/Peçane, te vendi i quajtur *Perdence*. Me të ishte edhe vëllai i bashkëshortes së tij, Shyhrete, i cili u plagos rëndë. Një ditë më vonë, bashkëluftëtarët e kanë varrosur Hamziun në Pagarushë/Pagaruša [Malishevë/Mališevo]. E kanë rivarrosur në muajin janar të vitit 1999 në

varrezat e Peqanit/Peçane. Përfundimisht, mbetjet e tij mortore janë varrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suva Reka më 18.09.1999.

Burimet: deklarata S.B, FDH-36852; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-20988; UÇK, *Lista e deshmorëve...*, FDH-36427.

Ali (Zymer) Kermeni

(15.11.1924, shqiptar nga Bllaca/Blace, komuna e Suharekës/Suva Reka, gjykatës i pensionuar, tetë fëmijë)

Aliu jetonte në bashkësi familjare me bashkëshorten Xhemilen, djalit Lulëzimin, të rejën dhe nipin e vogël. Në muajin korrik të vitit 1998, e reja me nipin kanë kaluar te familja e saj në Prishtinë/Priština. Në datën 23.08.1998, forcat serbe e kanë bombarduar Bllacën/Blace, dhe Aliu me bashkëshorten dhe të birin kaluan në fshatin fqinj të Guncatit/Guncat [Malishevë/Mališevo]. Në disa ditët e ardhshme, Aliu me Lulëzimin rregullisht e vizitonin shtëpinë gjatë ditës, ndërkaq u ktheheshin në Guncat përpara se të binte terri i natës. Në shtëpinë e tyre në Guncat ishin vendosur pjesëtarë të UÇK-së. Por, në datën 30.08.1998, Aliu u kthye tërësisht nga Guncati në shtëpinë e vet. Më 7.09.1998, ushtarë të UÇK-së e njoftuan familjen se Aliu ishte zhdukur. Për fatin e tij nuk dihej asgjë deri më 5.10.1998, kur trupin e tij të pajetë e kishte gjetur komshiu Hajriz Guraziu. Trupi gjendej te vreshtat, afro 500 metra larg shtëpisë së Aliut [**Bllacë/Blace**]. Trupi ishte pa kokë. Hajrizi e ka identifikuar në bazë të dokumenteve. Ushtarë të UÇK-së e kanë mbuluar trupin me dhe. Në muajin nëntor, Lulëzimi e ka gjetur kokën e të atit, e cila ishte jo shumë larg vendit ku e kishin gjetur trupin. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Aliut në varrezat e fshatit Bllacë/Blace.

Burimet: deklarata L.K, FDH-36842; deklarata S.K, FDH-10944; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 121, FDH-23857.